



Nr. 6836/ Prot  
Dt. 16.12.21

Nr. 803/ prot.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Shkodër, më 13.12.2021

**LËNDA: Mbi vendimin Nr.66 datë 26.11.2021 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**


**KESHILI BASHKIAK VAU-DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, neni 56 i KPAD, Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 24, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, Ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin Social”, neni 15, pika 5, VKB Vau-Dejës nr.80 dat.24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetore afat-mesëm perfundimtare 2021-2023”, VKB Vau-Dejës Nr.84 datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e planit social vendor 2021-2026 në Bashkinë Vau-Dejës”, VKB Vau-Dejës nr.40 datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit, subvencionim i qerases në tregun e lire”, VKB Vau-Dejës Nr.41 datë 28.06.2021 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qerasë në tregun e lire, sipas strukturave përkatëse të banesave”, VKB Vau-Dejës Nr.51 datë 26.08.2021 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit”, materialit të dërguar nga sekretari i këshillit bashkiak Vau-Dejës me shkresën Nr.6831.prot datë 2.12.2021, u njoh me **VKB Vau-Dejës nr.66 datë 26.11.2021 mbi miratimin e (4) katër përfituesve dhe të vlerës së subvencionit të qerasë, aplikues në programin e “Subvencionit të qerasë në tregun e lire”**, akt i cili nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative, për të cilat Prefekti në zbatim të- nenit 8, shkronja “a” e ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkepunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 66 datë 26.11 2021

**“Për “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për aplikuesi në programin e “Subvencionit të qirasë, në tregun e lirë”**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 38 i Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM-së nr.362 prot, datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; Shkresës me nr.444/1 prot, datë 30.03.2021 nga Drejtoria e Statistikave Sociale, Tiranë mbi “Niveli e konsumit mesatar, të detajuar sipas madhësisë së familjes dhe për nivelin më të ulët territorial të disagregimit, 2019 ”; VKB-së nr.80, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitin 2021 dhe programeve buxhetore afatmesem përfundimtar 2021-2023, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës ”; VKB-së nr.84, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e Planit Social Vendor 2021-2023 në Bashkinë Vau Dejës”; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 “Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026” në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencion i qirasë , në tregun e lirë”; VKB-së nr.42, datë 28.06.2021 “Për miratimin e ngritjes së Komisionit të Strehimit dhe rregulloren e funksionimit të Komisionit të Strehimit”; VKB-së nr.51, datë 26.08.2021 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Subvencionit të qirasë, në tregun e lirë”; VKB-së nr.41, datë 28.06.2021 “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”; Relacionit nr.6561/1 prot, datë 16.11.2021 të grupit të punës, i ngritur me Urdhër të brëndëshëm nr.375 datë 12.11.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin



në terren”; Relacionit nr. 6549/1prot, datë 12.11.2021, të grupit të punës ngritur me Urdhër të brëndëshëm nr.359/1, datë 03.11.2021 “Për ndryshimin e udhërit nr.359 prot, datë 02.11.2021, për ngritjen e grupit të punës për verifikimin në terren”; Proces-Verbalit përfundimatar i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datën 17.11.2021 “Për instrumentin financiar të subvencionit të qirasë, në tregun e lirë” Sipas relacionit të Komisionit të Strehimit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë ;

### **KËSHILLI BASHKIAK VENDOSI**

1. Miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për aplikuesit në programin “Subvencion i qirasë në tregun e lirë” sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.
2. Subvencioni i qirasë do t’i jepet përfituesit që nga data e lidhjes së kontratës, pavarësisht nga data e miratimit të vlerës së subvencionit për përfituesit konkret (neni 39, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social”.
3. Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë mund të dalë nga kjo skemë pas një viti, nëse vërtetohet që ajo ka zgjidhur problemin e strehimit, ose nëse të ardhurat e familjes janë rritur mjaftueshëm për të përballuar pagesën e qirasë pa nevojën e bonusit, dhe skualifikohen sipas metodikës së përlllogaritjes së qirasë, (VKB nr 40, datë 28.06.2021)
4. Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë duhet të bëjnë deklarin pranë bashkisë në rast se u ndryshojnë kushtet e strehimit apo kushtet ekonomike. Familjet kanë detyrim që brenda 10 ditëshit të para të muajit të gjashtë nga momenti i fillimit të subvencionit të qirasë, duhet të bëjnë përditesimin e informacionit rreth ndryshimeve të familjes për kushtet e strehimit ose kushtet ekonomike me dokumentat perkates, në të kundër familja skualifikohet nga pagesa e subvencionit të qirase, (VKB nr 40, datë 28.06.2021).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes , Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale, si dhe Drejtoria e Ekonomise.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR  
**Mark BISHA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Ardian ÇELEPIJA**





Miratuar me 19 vota  
Vota Pro 19  
Vota Kunder -  
Vota Abstenim -  
Zbardhur me Datë 02.12.2021





Programi: Subvencioni i qirazë në tregun e lirë.

Vlera maksimale e subvencionit të qirazë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirazë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të bancave dhe të ardhurave të familjes

Nr Rendor	Emër	Mbëmber	Kategoria sipas neni 16, të ligjit nr.22/2018	Përthëria Familjare	Struktura e Apartamente (Bancec)	Vlera mesatare e qirazë të bancave në tregun e lirë, të miratuar me VKB nr 41 datë 28.06.2021	Qiraja reale	Të ardhurat Familjare mujore (neto)	Afesia përballues (%)	Qiraja e përbalueshme	Subvencionimi në muaj	Subvencionimi që mbulohet nga bashkia në Lek	Shuma që kërkohet nga buxheti i shtetit në Lek	Subvencionimi në vit në Lek	
1	Drita	Tanushit	Familje një prindërore që ka në ngarkim fëmijë. Familje me të ardhura shumë të ulta sipas neni 2, pika 45 e ligjit 22/2018 "Për Shtetimin Social"	3	1+1	7.000	10.000	26.640	15%	3.996	3.004.0	3.004.0	0	36.048.0	
2	Salvator	Marku	Familje me më shumë se 4 fëmijë, me të ardhura shumë të ulta sipas neni 2, pika 45 e ligjit 22/2018 "Për Shtetimin Social"	9	3+1	19.000	20.880	26.813	15%	4.022	14.978.0	14.978.0	0	179.736.0	
3	Gjelosh	Cuni	Familje që trajtohet me NE, Familje pa të ardhura sipas neni 2, pika 45 të ligjit 22/2018 "Për Shtetimin Social"	5	2+1	11.000	10.000	-	-	-	10.000.0	10.000.0	0	120.000.0	
4	Dashamir	Kurraj	Familje me të ardhura shumë të ulta sipas neni 2, pika 45 e ligjit 22/2018 "Për Shtetimin Social"	5	2+1	11.000	10.440	42.422	15%	6.363	4.076.7	4.076.7	0	48.920.4	
Totali/muaj												32.058.7	32.058.7	0	384.704.4

Shtimin : Subvencionimi i qirazë fillon që në datën e nënshkrimit të kontratës, që në muajin tetor 2021 - deri në ndryshimin e kushteve sociale ekonomike të banorëve.

KRYETAR  
Mark BISHA

Sekretarë Keshillit Bashkiak  
Ardian QULLERJA

